



REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT



Në bazë të nenit 22 dhe nenit 23 nga Ligji për parandalim të korrupsionit dhe konfliktit të interesave (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë, numër 12/2019), nenit 40 dhe nenit 41 nga Rregullorja për punë e Komisionit shtetëror për parandalim të korrupsionit, duke vepruar pas denoncimit nga parashtruesi ....., Komisioni shtetëror për parandalim të korrupsionit (KSHPK), në vazhdimin e seancës së 46-të të mbajtur me datë 19 shkurt 2021 morri

### VENDIM

Procedura për lëndën nr.12-5353 nga viti 2019 e formuar pas denoncimit nr. 12-5353/1 me datë 25.11.2019, dorëzuar nga parashtruesi ....., **NDËRPRITET.**

Në përputhje me dispozitat e Ligjit për parandalim të korrupsionit dhe konfliktit të interesave, Komisioni shtetëror për parandalim të korrupsionit vërtetoi se është e palëndë veprimi të mëtutjeshëm kompetent në lëndën me numër 12-5353 nga viti 2019, nuk ka elemente për veprim të mëtutjeshëm për lëndën.

Lënda me numër 12-5353 nga viti 2019 të mbyllet dhe të arkivohet.

Deri tek parashtruesi i denoncimit të dorëzohet Vendimi i KSHPK me sqarimin

Vendimi i Komisionit shtetëror për parandalim të korrupsionit, me sqarimin, në formë të formë të depersonalizuar, të publikohet në web-faqen e Komisionit shtetëror në afat prej 5 (pesë) ditë nga dita e marrjes së vendimit.

### SQARIM

Lënda me numër 12-5353 nga viti 2019 është formuar në bazë të denoncimit nr. 12-5353/1 me datë 25.11.2019, dorëzuar deri tek Komisioni shtetëror për parandalim të korrupsionit, nga parashtruesi .....

Në denoncil flitet për akuza për keqpërdorim të detyrës zyrtare dhe autorizimit nga ana e kryetarit të komunë së ....., gjatë kohës procesit zgjedhor për zgjedhjet për kryetarë të shtetit të viti 2019, dhe kryerje e shkeljes të dispozitave të Kodit zgjedhor për ndalim të përdorimit të mjeteve buxhetore, gjegjësisht ndalim i veprimeve të institucioneve publike nga dita e shpalljes së zgjedhjeve, si dhe thyerje të dispozitave të Ligjit për parandalim të korrupsionit dhe konfliktit të interesave, të cilët e rregullojnë ndalesën e veprimit nga momenti i miratimit të vendimit për shpallje të zgjedhjeve për zgjedhje të kryetarit të Republikës së Maqedonisë së Veriut. Gjegjësisht, në denoncim flitet se gjatë kohës derisa ka zgjatur procesi zgjedhor për kryetarë shteti 2019, kryetari i komunës së ....., ..... disa herë, në periudhën prej 15.02.2019 deri më 12.04.2019 ka dërguar ndihmë sociale më tepër qytetarëve ose të 38 qytetarëve në vlerë prej rreth 200.000 denarë, që dokumentuar me akt – Të dhëna për pagesë së njëhershme ndihmë në të holla në përputhje me masat dhe aktivitetet e komunës së ..... në fushën e mbrojtjes sociale në vitin 2018 dhe 2019, numri i komunës ..... me datë 17.07.2019, të cilët veprime, sipas parashtruesit të denoncimit paraqesin pagesa jo të rregullta gjatë kohës së procesit zgjedhit dhe e dënueshme me ligj.

Gjatë rishikimit të denoncimit, KSHPK i merr parasyshë akuzat e parashtruesit dhe në bazë të të gjitha rrethanave të rastit, konstaton se në rastin e lëndës bëhet fjalë për pagesë të ndihmës sociale të më teprë personave e cila është paguar si ndihmë e njëhershme në të holla në përputhje me Programën për masa dhe aktivitete të komunës ..... në fushën e mbrojtjes sociale gjatë viteve 2018 dhe 2019, kurse veprimet e denoncuarra për të cilat ngarkohet personi i përmendur kanë të bëjnë me periudhën kohore e cila tashmë ka kaluar dhe procesi zgjedhor ka përfunduar gjegjësiht, zgjedhjet për kryetarë të shtetit janë mbajtur me 21 prill të viti 2019 kurse me shpalljen e rezultateve përfundimtare për zgjedhje të kryetarit të shtetit, nga ana e Komisionit shtetëror të zgjedhjeve me 11 maj të viti 2019 është shpallur se zgjedhjet për kryetar të shtetit kanë përfunduar. Nga e theksuara del se është e pakuptimt dhe palëndë veprimi i mëtutjeshëm i Komisionit shtetëror për parandalim të korrupsionit për këtë lëndë, me çka KSHPK vlerëson se nuk ka elemente për veprim të mëtutjeshëm për rastin e lëndës, procedura për lëndën të ndërpritet kurse lënda të mbyllet dhe të arkivohet.

Në bazë të tërë kësaj të shënuar më sipër, Komisioni shtetëror për parandalim të korrupsionit vendosi sipas dispozitave të këtij vendimi.

Dorëzuar deri tek: Arkiva dhe Parashtruesi  
Pas përfundimit të KSHPK  
Përpunoi: J. C., këshilltarë  
Miratoi: G. T., anëtar i KSHPK

**KOMISIONI SHTETËROР PËR  
PARANDALIM TË KORRUPTIONIT  
Kryetarë: Biljana Ivanovska**